

PHILIPPE JACCOTTET

Premtimi i prushit




PHILIPPE JACCOTTET

Philippe Jaccottet

Premtimi i prushit

[Poezi 1946-1967]

Me hyrje nga
Jean Starobinski



Përktheu nga origjinali:
ROMEO ÇOLLAKU



aleph

Botohet në Shqipëri më 2018
nga Klub Aleph
Rruga Emin Duraku, Pallati 10,
Apartamenti 8, Tiranë

Ky libër është shtypur në Shqipëri
nga shtypshkronja Maluka

© EDITIONS GALLIMARD, 1954; 1958; 1967; 1971

Eseja hyrëse © Jean Starobinski

“© of the translation: S. Fischer Foundation by order of TRADUKI”

© Për botimin shqip Aleph, 2018

Germa e tekstit është *Granjon*

Arti grafik
Kleida Maluka

ISBN 978-9928-4395-6-7

“Botimi i kësaj vepre u mbështet financiarisht nga Rrjeti TRADUKI një projekt i Ministrisë Federale për Europë, Integrim dhe Punë të Jashtme të Republikës së Austrisë, i Zyrës së Punëve të Jashtme të Republikës Federale të Gjermanisë, i Fondacionit zviceran për Kulturën “Pro Helvetia”, i “KulturKontakt Austria” (ngarkuar nga Zyra e Kancelarit Federal të Republikës së Austrisë), i Institutit “Goethe”, i Fondacionit “S. Fischer”, i Agjencisë sllovene të librit “JAK”, i Ministrisë së Kulturës së Republikës së Kroacisë, i Departamentit të Kulturës të Qeverisë së Principatës së Lihtenshtajnit, i Fondacionit Kulturor të Lihtenshtajnit, i Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë, i Ministrisë së Kulturës dhe Informimit të Republikës së Serbisë, i Ministrisë së Kulturës së Republikës së Rumanisë, i Ministrisë së Kulturës së Malit të Zi, i Panairit të Librit në Lajpcig dhe i Ministrisë së Kulturës së Republikës së Maqedonisë.”

traduki 

P Ë R M B A J T J A

Jetëshkrim IX

Tek flasim me zërin e ditës, nga JEAN STAROBINSKI XIII

GJONI

[Nata është një qytet i madh në gjumë]	3
[Je këtu, vërtitet zogu i erës]	4
[Gjersa jam një i huaj në jetën tonë]	5
[Tani e di se nuk zotëroj asgjë]	6
[Porsi një njeri që do t'i pëlqente pikëllimi]	7
[Rri i qetë, do ndodhë! Avitesh]	8
Portovenere	9
Lajmet e mbrëmjes	10
E brendshme	11
Agrigente	12
Ninfa	13
Lundrimi	14
Farëzimi	15
Ujërat dhe pyjet	20

I P A D I T U R I

Lutje mes natës dhe ditës	25
Rishtas shënime për farëzimin	26
Shënime për agullimën	27
Agullimës	30
E fshehta	31
Durimi	32
Zëri	33
Dimri	34
I padituri	35
Puna e poetit	36

Përgjimi i përzishëm	37
Ciganët	38
Letër e njëzet e gjashtë qershorit	39
E papritura	40
Pas hapave të hënës	41
Fjalë në erë	42
Arsyeja	43
Plagë e parë së largu	44
Qeraxhiu	45
Na ndriçoftë mbarimi	46
Beteja e pabarabartë	47
Në një shtjellë dëbore	48
Diell dimri	49
Pohimi në terr	50
Largësitë	51
Shëtitja në fund të verës	52
Libri i të vdekurve	53

A J R Í

FUND DIMRI

[Pakogjëra, asgjë që t'ia vrasë]	61
[Lot të shpërndarë]	62
[Në barin që i mbijeton dimrit]	63
[E vërteta, e pavërteta]	64
Hënë agullime verore	65
Hënë dimri	66
[Rini, po të harxhoj]	67
Në çerekun e fundit të natës	68
[Atje ku toka plotësohet]	69
[O shok i së errëtës]	70
[Në rrethojën e pyllit të dimrit]	71

ZOGJ, LULE DHE FRUTA

[Një fill kashtë shumë lart në agullimë]	73
[Çdo lule veç falë natës]	74
[Po eci]	75

[Ajo që digjet duke grisur ajrin]	76
[Mu në të mbaruar të natës]	77
[Një çafkëlore e trëndafiltë në horizont]	78
[Syri]	79
[Ç'është vështrimi?]	80
[Ah! idili dhe një herë]	81
[Nuk dua më të rri]	82
Trumbë dejkash	83
[Mes këtij afshi të ëmbël të ditës]	84
Fruta	85
[Hija ngadalë e reve]	86
[Rrufeja e gushtit]	87
[Fruta me kalimin e kohës më të kaltërreme]	88
[Meraku për turtullin]	89
[Gjethe a shkëndija të detit]	90
[Ku askush nuk mund të banojë apo të hyjë]	91
[Vegime më ikanakë]	92

FUSHË TETORI

[Ëmbëlsia e përkryer u shfaq përtej]	95
[Një ditë të tërë zërat e përunjur]	96
[Dhitë në kullotë]	97
[Toka mbarë e dukshme]	98
[Mollë të shpërndara]	99
[Në hapësirë]	100
Zogj	101
Agullimë	102
[E kam të vështirë të heq dorë nga pamjet]	103
Pemë I	104
Pemë II	105
Pemë III	106
[Do ta ruaj në vështrim]	107
[Do ta kem përherë në sy prapëseprapë]	108
[Dhe ca re shumë lart në qiellin blu]	109

NJË BOTË

[Peshë gurësh, mendimesh]	111
[Lule ngjyrë blu]	112

[Prehje]	113
[Pak dua t'ia di për fillimin e botës]	114
[Ta pranosh nuk bëhet]	115
Viaticum	116
[Botë e lindur nga një grisje]	117

U R I M E

I	119
II	120
III	121

M Ë S I M E

[Qoftë në kënd të dhomës. Numëroftë]	125
[Dikur]	126
[Rrush dhe fiq]	127
[Nuk do doja tjetër veçse të largoja]	128
[Në mos e para goditje, është shndritja e parë]	129
[Ç'pandehja se lexoja në të, kur merrja guximin të lexoja]	130
[Midis yllit më të largët dhe nesh]	131
[Memec. Nyja e fjalëve nis të zgjidhet]	132
[«Kush do më ndihmojë? Asnjëri nuk vjen dot gjer këtu]	133
[Është sipër nesh tashmë]	134
[Mund ta quajmë tmerr, gjë e pistë]	135
[Mjerim]	136
[Një fromë e thjeshtë, një nyjë e lehtë ajri]	137
[Griset, çrrënjaset]	138
[Më asnjë fromë]	139
[Tani nuk është më ai]	140
[Ngrita sytë]	141
[Fëmija, mes lodrave, zgjodhi, për të vënë]	142
[Po të ish e mundur (e kush ka për ta mësuar ndonjëherë?)]	143
[Mbase, tha pushimi, kam patur veç një dëshirë të vetme]	144
[Dhe unë tashmë i tëri në ujëvarën qiellore]	145
[Ti megjithatë]	146

<i>Shënime</i>	147
----------------	-----

JETËSHKRIM

1925. Lindja e Philippe Jaccottet-së në Moudon të Zvicrës.
1933. Familja e tij vendoset në Lozanë.
1944. Fillon studimet për filologji në Lozanë. Në të njëjtën kohë, boton poezitë e para.
1945. Boton përmbledhjen «Trois poèmes aux démons» në një shtëpi të vogël botuese.
1946. Ndërmerr udhëtimin e parë në Itali, ku njihet me Ungaretti-n. Në vjeshtë vendoset me banim në Paris. Nis të bashkëpunojë me shtëpinë botuese Mermod, ku boton, fillimisht, përkthimin e romanit të Thomas Mann-it «Vdekje në Venecie». Udhëtime të shpeshtë në Itali.
1947. Boton poemën «Requiem».
1953. Martohet me piktoreshen Anne-Marie Haesler dhe vendosen me banim në Grignan (Drôme), ku jeton qysh prej asaj kohe. Botohet përmbledhja «Gjoni dhe poezi të tjera» në sh.b Gallimard.
1954. Lindja e të birit Antoine. Veç poezive të tij, lëvron pa pushim përkthimin, si dhe kritikën letrare, duke bashkëpunuar me revista të ndryshme, ndër të cilat edhe *Nouvelle Revue Française* (N.R.F.).
1955. Përkthen «Odisenë» e Homerit, që do të botohet më vonë nga Club Français du Livre.
1957. Botohet «La Promenade sous les arbres», përmbledhje prozash të shoqëruara me piktura të bashkëshortes. Përkthen «Njeriun pa cilësi» të Musil-it dhe «Hyperionin» e Hölderlin-it. Gjatë

- dhjetëvjeçarit në vazhdim ka për të përkthyer një pjesë të madhe të veprës së romantikut gjerman.
1958. Botohet përmbledhja «I padituri» (Gallimard).
1960. Lindja e së bijës Marie.
1961. Botohet, gjithnjë te Gallimard, përmbledhja me proza «Éléments d'un songe» dhe tregimi «L'Obscurité».
1963. Botohet përmbledhja poetike «Farëzimi», në sh.b. Payot të Lozanës.
1964. Në bashkëpunim me J. Bertrand, G. Nicole dhe Ungaretti-n, përkthen pjesë nga vepra e Leopardi-t.
1966. Për përkthimin e «Njeriut pa cilësi» të Musil-it, nderohet me Çmimin e Akademisë së Darmstadt-it. Boton esenë «Autriche».
1967. Boton përmbledhjen poetike «Ajrí» (Gallimard).
1968. Boton kronikat poetike me titull «L'Entretien des Muses» (Gallimard) dhe esenë «Goustave Roud» (Seghers).
1969. Boton përmbledhjen me poezi «Mësime» (Gallimard).
1970. Boton përmbledhjen me proza «Paysages avec figures absentes» (Gallimard), për të cilën nderohet me Çmimin e Qytetit të Lozanës.
1971. Boton esenë «Rilke par lui-meme» (Seuil).
1972. Nderohet me Çmimin Montaigne. Përkthen poezi të Rilke-s, që do të botohen nga sh.b. Seuil.
1973. Botohet te Gallimard një vëllim me poezi të Ungaretti-t, përkthyer nga Jaccottet, Pierre-Jean Jouve, Francis Ponge, etj.
1974. Botohet përmbledhja poetike «Chants d'en bas» (Payot).
1975. Botohet proza «À travers un verger» (Fata Morgana).
1976. Përkthen një përzgjedhje nga letërkëmbimi i Rilke-s me Lou Andreas-Salomé-në, Pastërnakun, Cvetajevën, etj.
1977. Botohet përmbledhja me poezi «À la lumière d'hiver» (Gallimard).
1980. Botohet proza «Les Cormorans» (Idumée).
1981. Botohet proza «Beauregard» (Maeght).
1983. Botohet përmbledhja poetike «Pensées sous les nuages» (Gallimard).
1987. Botohet përmbledhja me ese «Une transaction sècrete» (Gallimard).
1990. Botohet përmbledhja poetike «Cahier de Verdure» (Gallimard).

1993. Botohet «Cristal et fumée», shënime udhëtimesh në Greqi, Andaluzi dhe Egjipt (Fata Morgana).
1994. Botohen përmbledhja poetike «Après beaucoup d'années» (Gallimard) dhe ajo me ese «Écrits pour papier journal: chroniques 1951-1970» (Gallimard).
1996. Botohet në sh.b. Fata Morgana një vëllim me përkthime të tij nga hajku japonez, si dhe «La Seconde Semailson» (Gallimard), pra «Farëzimi II».
1997. Botohet një përzgjedhje nga gjithë përkthimet e tij poetikë, me titull «D'une lyre à cinq cordes» (Gallimard).
2001. Botohen përmbledhja me poezi dhe proza «Et, néanmoins», si dhe «Notes du ravin» (Fata Morgana), «Carnets 1995-1998» (Gallimard).
2002. Nderohet me Çmimin Goncourt për gjithë veprën e tij poetike. Botohet nga Gallimard letërkëmbimi me poetin zvicerian Goustave Roud.
2003. Botohet eseja «À partir du mot Russie» (Fata Morgana).
2005. Botohet eseja «Remarques sur Palézieux» (Fata Morgana).
2008. Botohet nga Gallimard letërkëmbimi i tij me Ungaretti-n.
2010. Nderohet me Çmimin Schiller.
2011. Nderohet me Çmimin Guillevic.
2015. Botohet përmbledhja me ese «Un calm feu» (Fata Morgana).

Kur u qasesh këtyre poezive, të zgjohet një mirëbesim. Vështrimi ynë, duke kaluar prej njëres fjalë te tjetra, vëren të shpalohet një ligjërim i dëlirë, që e banon ndijimin, ashtu sikundër zëri i saktë banon melodinë. Kurrfarë shtirjeje, kurrfarë teprie, kurrfarë maske. Këtë ligjërim, që na jepet pa dredha, mund ta rrokim pa patur nevojë të tregohemi finokë. Një magjepsje, një mirënjohje na rrëmben: theksi poetik, shprehja poetike (porse e çliruar nga çdo sajesë retorike), na qenkan gjëra të mundshme, përherë të mundshme! Ndaj pra, duke vëzhguar pjesën më të madhe të prurjeve të sotme, ngjante sikur lypsej të dëshpëroheshim, teksa nuk ndeshnim tjetër veçse kujtimin e thyer të asaj ç'pat qenë Poezia...

Për mirëbesimin që i zgjon lexuesit, Philippe Jaccottet-ja i detyrohet, pa dyshim, rregullit të cilin i dikton vetes dhe prej të cilit shtrëngohet të bëhet dorëzanë i çdo fjale që shkruan: ai i druhet teprimit, qëndrimin hijerëndë, fjalëve të mëdha; nuk u zë besë vegimeve farfuritës; i kall datën e pathemelta. Mëkati më i rëndë, për të, do të ishte të mos i gjegjej dot poezisë me gjestet e jetës, me ngjyrimet e gjallë të botës së rrokshme, me sigurinë (me sigurinë më të paktë) të mendimit. Sa larg u ndodhëmi prej një poetike të shpërthimit të lirshëm, të takimit të rastësishëm, të gjasave të pafundme! Sa larg u ndodhëmi, po ashtu, prej çdo strukture të paramenduar! Shquajmë, në çdo fjalë, anësinë pothuajse të pashpresuar burimore, por edhe miratimin (ndonjëherë zemërdridhur) që ia vulos vlefshmërinë dhe i hap rrugë për t'u shkruar në faqen e letrës. Philippe Jaccottet-ja nuk thotë kurrë asgjë më shumë nga sa beson se është në gjendje të thotë. Këtu haset ajo që, ndoshta, duhet quajtur themeli etik i kësaj poezie: Jaccottet-ja nuk gjykon se e vërteta është një fjalë e kotë, as se mbetet ëndërr të mëtohet ndërthurja, në një marrëveshje të pazgjydhshme, e së vërtetës me ligjërimin poetik. Poezia e Jaccottet-së e merr forcën, jo nga energjia improvizuese, as nga mendjemprehtësia

ndërthurëse, por nga nevoja e vazhdueshme e vërtetësisë: nevojë edhe më e domosdoshme përderisa nuk mbështetet në asnjë dituri të hamendësuar, në asnjë bindje të patundur. E vetmja dorëzani e saj është lidhja pyetëse që mban me botën. Është me rëndësi, ama, ta saktësojmë: e vërteta – kaq e vështirë për t'u mbrojtur mes gënjeshtreve që na bezdisin – nuk është për Jaccottet-në as ndonjë besim, as ndonjë sistem idesh, as edhe ndonjë thirrje ndjenje. Ajo zbulohet te cilësia e një lidhjeje me botën, te drejtësia gjithnjë e rilindur e marrëdhënies me atë që e përballim dhe na bishtnon. Çiltërsinë poetike të Jaccottet-së nuk e shemb goditja prej vështirësive që, kurdoherë, ndesh «kujdesi i sinqeritetit»; qenia është këtu krejtësisht një kërkim dhe, për të, të tregohesh besnik ndaj vetes – besnik ndaj së vërtetës – nuk do të thotë të shprehësh ndonjë «natyrë» paraardhëse, por ta shpërfaqësh kërkimin te vetë fjalët që e bëjnë të përparojë. Një kundërshti e dukshme ngërthen, në këtë vepër, padijen dhe të vërtetën, e bën padijen strehë të së vërtetës më të çmuar – me shartin që mos-dija mbetet përjetësisht e shqetësuar, si dhe e hapur ndaj gjithë gjasave të dritës në botë.

Duket se basti, për poetin, nuk është veç të vërë në provë jetën e tij vetjake: bëhet fjalë për t'i dhënë lexuesit shembullin ngjites të një ligjërimi të aftë për të vendosur një marrëdhënie të drejtë e të saktë me atë ç' ai dëfton. Nuk presim nga një poet më shumë se dhurata e saktësisë dhe i detyrohemi mirënjohje si të na kishte zbuluar vetë drejtësinë: sepse saktësia kujdeset për mundësinë e komunikimit; është premtim ardhmërie për mirëkuptimin midis njerëzve. Këtu, nuk do t'i mëshonim këtij funksioni, elementar ç'është e vërteta, nëse sot nuk do të na zhdukej nga sytë me çdo mënyrë.

*

Goja që thotë unë është shfaqur pra këtu në fjalën e saj, nga fjala e saj. Është shfaqur, domethënë është vënë para rrezikut, e cunguar nga çdo mbështetje. Por, në radhë të parë, e pranishme, dhe e pranishme porsì një njeri. Dhe këtu Philippe Jaccottet-ja mbrohet kundër pritjes,

mjaft të përhapur sot, të përjashtimit të shkrimtarit nga teksti dhe shndërrimit të shkrimit në një veprimtari pa subjekt, që veç te vetja e gjen energjinë. Ky, Philippe Jaccottet-ja nuk ia zhduk identitetin vetes, nuk i mungon ligjërimin të tij. Dëshiron gjithnjë të njëjtësohet me zërin e vet, nuk e detyron atë të hyjë në role përrallorë, ku do të shpërndahej në një shumësi figurash ndërluftuese. «Pjatararësi»¹ (kjo poezi e bukur nga përmbledhja I padituri) nuk zhvillon një identitet të ndryshëm, por një alegori të tejdukshme, një pamje paksa qesëndisëse të vetë punës së poetit, që duket se nuk ia lejon vetes t'ia dorëzojë ligjërimin një zëri shqërbyes, nuk joshet pra prej dramaturgjisë, prej shpikjes së shumëzëshme; nuk e braktis së tepërmi poezinë në një jetë të pavarur, në horizontin e pabanuar të një gjuhe pa njerëz. Kur bëhet rrëfyes – si tek Errësira – ai i merr leje një dubluesi të vetes, një kundërshtuesi të brendshëm, e folmja e dëshpëruar e të cilit nuk i duket rrënjësisht e huaj.

Nëse poezia qëndron e lidhur me atë që e shpreh, le të shtojmë menjëherë se ajo nuk qeveriset nga një personalitet tiranik, i merakosur vetëm për ta lënë gjurmën e tij te një stil i veçantë e te një gjuhë e pangjashme. Ndoshta kjo është gjëja më e adhureshme që na jep vepra e Philippe Jaccottet-së: në qoftë se nuk e ka mohuar «funksionin shprehës», që është i pandashëm nga tradita e madhe lirike, subjekti të cilit ajo i kthehet është më i përkormi i mundshëm, më i shqetësuar për të lehtësuar praninë e vet, për t'u bërë pothuajse i padukshëm. Veta e parë njëjës, ndaj së cilës këta tekste janë nënshtruar hap pas hapi, rrëzon çdo autoritet: ajo nuk është tjetër veçse pyetje, uverturë e shqetësuar, thjeshtësi. Pak gjëra ka për të thënë rreth vetes: thotë atë që i mungon, atë që gjurmon, atë që e zbulon ndonjëherë, dhe më dendur atë që nuk arriti ta mbante. Po t'i kushtojmë vëmendje zhvillimit të shkrimit poetik të Philippe Jaccottet-së, do të vërejmë se ai përparon krah për krah me një shuarje e me një vetëpërmbajtje, që, gjithnjë e më të theksuara, shtojnë mundësitë e tejdukshmërisë: shohim dalëngadalë sesi zhduket hollësia autobiografike, që përvijohet ende te disa prej poezive të përmbledhjes Gjoni. Poezia «Lutje mes natës dhe ditës», me të cilën hapet I padituri, përgjërohet: Që agullima [...] të ma fikë fabulën,

emrin me zjarr të ma mbulojë. Në hyrje të Farëzimit², lexojmë: Kur jepesh shumë pas vetes shtohet turbullimi i jetës. Dhe gjithçka kalon sikur rritja e dritës, së dëshiruarës me afsh, të ishte shpërbleta e një asketizmi, ku ndërgjegjja e kufizon pothuajse deri në asgjë praninë e vet:

Fikja qoftë mënyra ime e rrezatimit.

Megjithatë, kjo harresë e vetes nuk bën të merret si një leje që i jepet çdo veprimtarie të vullnetshme të ndërgjegjes dhe si një zotim anonimati të plotë. Vargu që sapo përmendëm nuk e përjashton unin. Përunjesisht i përkushtuar ndaj shuarjes, subjekti vetjak këmbëngul, në përgjim, por këtej e tutje i shpenguar nga historia e vetvetes, më gjerësisht i hapur ndaj dukurive të botës, më i aftë «për të folur me zërin e ditës». E çliruar nga përkujdesja për veten, ndërgjegjja nuk ka sesi të mos jetë më e prirur për t'iu dorëzuar një marrëdhënieje më të drejtë me atë që, së jashtmi, i intereson; me skenën e madhe që na është caktuar përditë: tokën, hapësirën, ajrin, dritën, erën, kohën. Për asnjë çast ligjërimi i Philippe Jaccottet-së nuk heq dorë nga detyra e vënies së vetes në provë, nga kërkimi i «përforcimit» që i nevojitet, nga kryerja e pjesës së rrugëtimit të vet. Ligjërim që rrokopuja dhe lajthitja nuk e mposhtin dhe që, mbi të gjitha, përballë asaj që iu kumtua nga bota, ruan një forcë përgjigjeje, një aftësi për të thënë ku ndodhet, qoftë edhe për të rrëfyer lakuriqësinë dhe hutimin e tij. Ligjërim që shkëputet nga krenaria e pavarësisë, por që, tek ajo pakogjë për të cilën vazhdon të jetë i sigurt, mbetet tërësisht zot i lëvizjes së tij. Një titull si Mësim e thotë shkoqur: Philippe Jaccottet-ja, përpara njëmendësisë së sendeve (dhe këtu kemi të bëjmë me njëmendësinë e një ankthi), ndjen detyrimin e një leximi të saktë, e një deshifrimi: të mësuarit, në një kuptim plotësues të fjalës mësim, bëhet nismëtar i këngës, «mësim i errësirave», mësim i madh. Si mund ta pranonte uni të zhvleftësohej, si nuk do të ishte domosdoshmëri prania e ndjeshme, gjersa duhen mbledhur gjithë energjitë e vëmendjes që të lartësohet teksti autentik i dhënë për t'u

lexuar (për t'u deshifruar)? Nga ana tjetër, si mund të ndërmjetësojë vetë poeti, gjersa më e çmuara për të është të thukë sa më mirë gjithë kumtin që jepet dhe mbulohet prej dukjeve?

Nëse poeti shuhet, nëse poezia nuk e pranon kanunoren e gjësë së pavarur dhe të plotë, a nuk shohim të gërryhet një bosh? Po, por kemi të bëjmë me vendin e tjetrës, asaj që poezia e synon pa e arritur, asaj që ajo e përball apo e dëshiron pa e kapur dot. Nëpërmjet asaj që emërton, poeti skicon atë që nuk i lejohet ta emërtojë. Kufizimi i qenies sikundër e dikton poeti, sikundër ia dikton poezisë, përkon me qenien e paanë të cilën ai ka vendosur ta përballë dhe drejt së cilës zëri dhe vështrimi hedhin harqet e brishtë të një ure të këputur. Ajo ç' mund të thuhet ende, shkon, megjithatë, shumë larg: është një mësymje e mrekullueshme, që kapërcen një pjesë të së ndërmjetmes. Por kjo, gjithnjë, nuk përbën asgjë më tepër se një pjesë dhe e vetmja shpresë e poetit është që atyre fjalëve, të cilat e ka forcën t'i nyjëtojë, t'u jepet një pasqyrim i atyre që nuk i lejohet t'i arrijë e t'i zotërojë: drita, vdekja apo rreziku.

Njëllonj si të thoshim se poezia, ndërsa nuk pretendon fare se i mjafton vetvetja, e shtrëngon veten të mos lërë t'i shpëtojë asgjë prej asaj ç' gjendet në zotërim të zërit të saj. Ndaj dhe skicimi kaq i qëndrueshëm i vargut, gërshetimi i qartësisë dhe përkulshmërisë së sintaksës, mënyra kaq mallëngjyese me të cilën vrulli i brendshëm, gjakues dhe në të njëjtën kohë i përunjur, zhvillohen përmes pavetësisë së një theksi të kulluar. Sepse Jaccottet-ja, duke synuar shumë lart, vendosi të nisej nga më poshtë. Lexueshmëria e përkryer e shkrimit të Jaccottet-së, le të themi më mirë rinisjet e tij (sidomos te tekstet në prozë), përmirësimet thjeshtëzuese, më duken të gjitha bashkë si dëshmi e pikënisjes së tij në jetën e përbashkët dhe si vërtetim i dashurisë së shpallur për dritën: po, e do aq shumë sa dëshiron që ajo të qarkullojë nëpër fjalët e përvijuara prej tij dhe të rrijë në përgjim, në mënyrë që të mos shkruset asnjë rresht, i cili të mos jetë për lexuesin një shteg i ndritshëm, qoftë edhe sikur të bëhet fjalë në të për natë e për hije. Zgjedhja e fjalorit të zakonshëm, vetëpërmbajtja e hovit metaforik, respektimi i lidhjeve «të natyrshme» dhe frazeologjisë së rregullt të gjuhës, të afta këto për

sa e sa variacione të rinj poshtë gishtërinjsh të ndjeshëm: ja ç'na bën aty për aty pjesëmarrës në çdo tekst të Jaccottet-së, ndonëse nuk jemi thirrur a grishur drejtpërdrejt. Asnjë pengesë e ndërkalur në rrafshin e përthithjes së tekstit, i cili na pranon, na mirëpret, na udhëheq drejt një ajri të kristaltë. Vështirësia nuk qëndron te depërtimi brenda poezisë, te qasjet e saj: kjo është vendosur më së miri – në zonën e nishaneve, ku pyetja e poetit takon pyetjen që secili prej nesh e ndjen të shpërgjimet në largësitë e fatit të vet. Kështu që vështrimi ynë mund ta shoqërojë poezinë; tok me të, mund të zhytet lirshëm, të hapë monopatin e vet në hapësirë dhe, në pikën më të thellë, të hasë cakun ku përtërihen së bashku ndjenja e intimitetit të fituar dhe brerja e ndërgjegjes për pazotësinë tonë kundrejt detyrës shpirtërore. Qartësia, te Philippe Jaccottet-ja, nuk është kurrë çështje e lehtë: është një rrezik më shumë, zhduk çdo ekran të rremë, për të na shpurë te drita e fortë e ditës, para pengesave të tejme, para mbrapshtisë së fundit a të parë, që drita më e madhe e përziën ende me lëbyrjen e saj.

*

Krijimi poetik, te Philippe Jaccottet-ja, shoqërohet nga një vepër e vëllimshme përkthimore, nga libra me kritikë letrare (Bashkëbisedim me Muzat, Goustaue Roud, Rainer-Maria Rilke), nga tekste në prozë (Shëtitja poshtë pemëve, Elementë të një ëndrre, Visore figurash të munguara), disa prej të cilëve janë të natyrës rrëfimore (Errësira) ose përzihen përkorazi me poezinë (Farëzimi). Le ta lëmë mënjanë çdo rend kronologjik, për të vëzhguar vetëm visoren rruzullore që na paraqesin këta libra: poezia është kurorëzimi, kreshta e tyre e sipërme. Shohim të ngjitet, si nëpër radhët e njëpasnjëshme të një shpati, një shteg i duruar që i drejtohet gjasës së poezisë. Është mbrojtje e keqe ta krahasosh këtë rrugëtim me një lloj kërkimi udhëzues, përfitimi prej të cilit nuk ka për të qenë ndonjë objekt i dhënë, ndonjë mësim i zbuluar, por buisja e një force të brendshme, gjithnjë e më të lirë dhe më të pastër, gjithnjë e më të shfaqur po ashtu, mbikëqyrjen dhe kohëzgjatjen e së cilës nuk

e dorëzaron asgjë. Nëse flas këtu për forcë, dua të dëftoj si mprehtësinë rrokëse, aftësinë e pritjes dhe të plagosjes, ashtu edhe vrullin veprues që i drejtohet lëndës së gjuhës dhe sundimit të marrëdhënies së saktë midis fjalëve.

Pa dyshim, përvoja prej përkthyesi i ushtron ndërkaq të dyja këto dhunti. E ç'domethënë të përkthesh, nëse jo të presësh, të mos jesh para së gjithash asgjë tjetër veçse një vesh i kujdesshëm ndaj një zëri të huaj, pastaj t'i japësh këtij zëri, me mjetet e gjuhës sonë, një trup tek i cili mbijeton ngjyrimi i parë? Çdo përkthim me të vërtetë i arrirë krijon një tejdukshmëri, shpik një gjuhë të re, të aftë për të përçuar një kuptim të mëparshëm: kështu ndodh me Musil-in, Ungaretti-n, Novalis-in, Hölderlin-in, Rilke-n, kur Philippe Jaccottet-ja na i sjell pranë. Një vepër kaq e arrirë ndërmjetëson dhe shpik.

Të njëjtën gjë do të thosha për tekstet «kritikë», duke shtuar se pritja, sado e ethshme qoftë, dyfishohet përherë nga një përgjigje: kritika e Philippe Jaccottet-së ka strukturën e rrasët të një dialogu. Asgjë nuk është me aq rëndësi për të, sa mundësia e pjesëmarrjes fatlume, e mirëkuptimit pa rezerva, e leximit të njëzëshëm. Por kjo njëzëshmëri arrihet vetëm kur ke të bësh me diçka tejet të kulluar. Steka është vendosur shumë lart. Jaccottet-ja di ta thotë, me këtë rast, përkorazi dhe ngultas, atë ç'e pengon të hyjë plotësisht në një vepër. Pa qenë shpërfillës kundrejt bukurisë, ka guximin (kjo është një prej meritave të Bashkëbisedimit me Muzat) të shënojë dallimet, parapëlqimet, shkurt, të gjykojë. (Një rrymë e tërë e kritikës bashkëkohore ka mohuar ta bëjë diçka të tillë, porse në dem të funksionit të përzgjedhjes, të cilin veprimtaria kritike nuk duhet ta lërë pas dore). Ajo ç'i bën kaq tërheqës librat që Jaccottet-ja ia ka kushtuar Gustave Roud-së, apo Rilke-s, është se na shpien, me fillin e një ligjërimi ku theksi vetjak është gjithnjë i pranishëm, drejt çastesh dëgjimi të plotë, ku mrekullia e poezisë – e ndriçuar, e lëvduar nga trajtesa – merr frymë dhe rrëzëllon prej vetë jetës së saj.

Këtij leximi të poetëve i bashkëlidhet një pyetje e botës. Për ta kuptuar këtë, mjafton të hapim librat Shëtitja poshtë pemëve,

Elementë të një ëndrre, Visore figurash të munguara. *Musil-i, Russell-i, apo edhe Hölderlin-i, janë pikënisjet: mendimi, me të ndjerë grishjen e tekstit ngashënjes, ndjek, në pavarësi të plotë, qëmtimin e dëshmime, nëpër shtigje ku çapitet i vetëm, pa ndihmë, pa udhërrëfyes, pa asnjë kriter tjetër përveç marrëdhënies së tij të brishtë me gjërat. Dhe, sakaq, çështja nuk është më vetëm t'i përgjigjemi tekstit të dashur, por edhe të marrim një leje të përligjur për të vështruar rretheqark, për të zënë me të njëmendtën një kuvendim, basti i të cilit është më i larti i mundshëm. Vështrimi vërtitet atëherë drejt botës që i qëndron përballë. Mendimi në vetë të parë, që buron së këndejmi, nuk është një monolog i mbyllur, as një ligjërim i drejtuar prej shtrëngesave të arsyes. Lëvizja mbetet ajo e një dialogu; por ky është një dialog i brendësuar dhe, sado «e rrjedhshme» e melodike qoftë gojëtaria, një shqetësim përherë gulçues të pengon që gjithë ç'ke pushtuar ta mbash përgjithmonë. Sepse, midis një termi dhe të kundërtit të tij, midis shfaqjes së jashtme dhe përsiatjes së brendshme, mandej, në gjirin e kësaj, midis ligjërimit të njërit dhe atij të tjetrit, midis dyshimit dhe kundërshtuesit të tij, kurrë nuk resht lëvizja e një kuvendimi të paqetë, e një pakënaqësie të pashqitshme, përveçse te pauza a te monopati mrekullibërës, ku (në të mirë të një vëmendjeje të shkajshme a ndoshta të një zbavitjeje sovrane) befas del në pah vetëm kulmi dhe vetëm drita është në gjendje të flasë: koha e pakapshme e një poezie... Për më tepër, tashmë, shtegu drejt poezisë – një rrugë kjo gjithë kthesa, e lirë, e pavendosur, e përcaktuar prej shenjash paralajmëruese – është shndërruar edhe vetë në poezi, falë dhuntisë që ka saktësia e shkajshme e së kumtuarës, falë «përkulshmërisë së zërit» që pyet botën. Po kështu edhe shesta, ku vetë shpresa e këngës bëhet këngë. Qasja, dëshira e poezisë merr trajtë poezie, paçka se në stilin e matur të shënimeve: Ëndërr e shkrimit të një poezie që do të ishte po aq e kristaltë dhe po aq e gjallë sa një vepër muzikore, magji e kulluar, porse jo e ftohtë; brerje ndërgegjeje pse nuk jam muzikant, pse nuk kam as njohuritë dhe as lirinë e muzikantëve. Një muzikë fjalësh të zakonta, e lartësuar ndoshta aty-këtu nga ndonjë apoaturë, nga ndonjë tril i kthjellët, një kënaqësi e pastër*

dhe e qetë për zemrën, pikërisht me aq sa melankoli lypset, për shkak të brishtësisë së gjithçkaje. Gjithnjë e më shumë bindem se, në paç mjetet, nuk ka dhuratë më të bukur se kjo muzikë, tronditëse jo me atë që shpreh, por vetëm me bukurinë e saj.

I shkurtër është monopati, e përkohshme është plotësia e ajërt e poezisë. Pas qasjes së gjatë, vegimi na u dha në ikje, por pas vegimit, ja sërishmi ndarja dhe pasiguria mbi atë që u bë e rroqshme (a vetëm sa u shfaq përgjysmë). Por a mund të shpresojmë për më shumë? Philippe Jaccottet-ja nuk e beson. Ta mbash veten si zotërues të sigurisë, ta dëshirosh një «banor të jetës së vërtetë», të kërqosh që shkëndija e dashurisë së tërësishme të mos shterojë: ky është, pa dyshim, në sytë e Jaccottet-së, gabimi më i madh, të cilit i është taksur të dënohet më rëndë se çdo gabim tjetër. Vlen për t'u shënuar se tri nga veprat në prozë të Philippe Jaccottet-së e marrin shtysën prej këtij vetëbesimi pronor: Edhe I padituri fillon me një «Histori të koprracit», që godet kujdesin për «pasuritë e ruajtura kush e di për ç'kohë». Nëse përmend, te Shëtitja poshtë pemëve, qëllimin mistik të George William Russell-it (A.E.), nëse ripërvijon, në fillim të Elementëve të një ëndrre ëndrrën muziliane për një kthim në parajsë, nëse na bën të dëgjojmë, te tregimi i mrekullueshëm parabolik i Errësirës, ankimin e dëshpëruar të një «zotërie» të rënë nga vakti që është gjykuar «ngadhënjimtar qysh nga fillimi» –, vazhdimisht, Philippe Jaccottet-ja e ndjen veten të detyruar të regjistrojë mynxyrën pa emër që bie mbi vullnetin kryelartë, mbi ata që pandehin se kanë shtënë në dorë, se ruajnë dhe mbajnë të vërtetën, se i vënë emër «të parrokshmes», se e kapërcejnë zonën e dukurive për të depërtuar në mbretërinë e thelbeve të patjetërsueshëm. Dhe, nëse jep e merr për ta goditur këtë gabim, e kuptojmë më së miri se kjo ndodh ngaqë dikur e ka adhuruar edhe vetë dhe, ndonjëherë, është bërë edhe ai pjesë e asaj qokëkrisjeje. Por, që t'i qëndrojmë të vërtetës, «drita nuk i jepet atij që e kërkon», se lartësinë nuk mund ta kemi vendbanim të përhershëm, se hija nuk resht së na mposhturi. Ikari bie dhe zhduket poshtë dallgëve, aksident i parëndësishëm i visores: atëherë, shohim tokën, bujkun dhe punët e tij të ngeshme, rrëkenë që shkon, qerthullin e stinëve, një botë

dukurish në ndryshim. Një botë nga nuk mungon doemos bukuria, por ku forcat e mbrapshta, vdekja, mjerimi, «tërbimi», nuk reshtin së na kërcënuari, qoftë edhe po të largohemi prej këtyre metropoleve të rërës dhe të dhimbjes, që janë qytetet: kjo botë me zor e banueshme është i vetmi risk i yni dhe nuk fitojmë asgjë duke u shkëputur prej saj.

Ç'mbetet? Pyetja përtërihet, pak nga pak, me ngulm, në veprën e Jaccottet-së: është pyetja e atij që pikasi, në mënyrë të pakthyeshme, ndalimin që iu kundërvu pandehmave të kryelartësisë. Ç'mbetet? Në mos kjo mënyrë për të shtruar pyetjen që quhet poezi dhe që është, me sa duket, mundësia e nxjerrjes së një kënge nga vetë caku, e gjetjes diqysh të një gërxi në humnerë për t'u mbajtur sipër saj, në mos për ta kaluar (që do të thotë ta zhdukësh); një mënyrë për të folur mbi botën që nuk e shpjegon botën, sepse kjo do të nënkuptonte ngurtësimin dhe asgjësimin e saj, por që e tregon të mëndur vazhdimisht nga mohimi për t'u përgjigjur, të gjallë sepse e padepërtueshme, të mrekullueshme sepse e tmerrshme... Kemi pra të bëjmë me një varfëri të madhe, një zhveshje të përkryer, një rrezik pa anë e pa fund, dhe asnjë premtim për ta zbutur, as edhe një vegim së paqë. Njëqind herë do ta kem thënë: ajo ç'më mbetet është pothuajse një hiç. Mirëpo Jaccottet-ja shton në çast: Por është mu si një deriçkë e vockël, nëpërmjet së cilës duhet të kalojmë, përtej së cilës asgjë nuk dëshmon se hapësira nuk është aq e madhe sa e patëm ëndërruar. Bëhet fjalë vetëm për kalimin e portës dhe që kjo nuk mbyllet një herë e përgjithmonë. Të jesh veç një i paditur, të qesh në zotërim veç një ligjërim të brishtë, pa siguri, të gjendesh si me shpatulla për muri në errësirë dhe në kurrkund: kjo është rrethana nga e cila duhet pa pushim të nisesh. Të nisesh pa pushim, të rifillosh: kjo do të thotë se Jaccottet-ja nuk pajtohet me palëvizshmërinë, nuk i përshtatet dështimit. Nëse «vendi i vërtetë» nuk është i arritshëm, gabimi i përkundërt do të ishte të rrinim këqëfortësisht në mes të natës, të zhyteshim atje dëshpërimisht, siç bën zotëria i rënë nga vakti, tek Errësira. Kur Jaccottet-ja shkruan: Të nisesh nga hiçi, ky është ligji im (shprehje thellësisht ndriçuese, të cilën Jean-Pierre Richard-i e vendosi në krye të studimit të tij të bukur),

gjejmë atje pohimin e një prejardhjeje të detyrueshme – hiçin – por edhe një pikënisje. Nisje shtigjeve të tokës, pa shpresën për zaptime, pa synim të caktuar. Por ligjërimi që lartësohet, i prejardhur nga nata dhe nga hiçi, sjell me vete rastin e një kalimi te drita. Cila dritë? Jo ajo e përtejgjatë. Kjo e çdo agullime të kësaj bote, mbartëse edhe e rrezikut të perëndimit të saj. Atëherë e kuptojmë ç'nevojë e bën Jacottet-në në tërësi njërin prej poetëve më të mrekullueshëm të mëngjesit, atë që mund të shkruajë: Pasiguria është motivi, hija është burimi... Nga thellësitë e mia, me gojën time, kurrë nuk foli tjetërkush veç vdekjes. Çdo poezi është zëri që i jepet vdekjes.

Ende duke u mbështetur tek errësira e pafundme
dhe nata e egër duke më shtyrë nga pas
i rraskapitur në këtë agullimë nëntori
shoh plorin e thëllimit tek çan me flakërima
ndërsa mbrapa nëpër një dritë të fortë
hija po lëron.

Kuptojmë edhe cila lidhje intime i bashkon, nga njëra anë, kalimet e dukshëm, si ai i stinëve, ai i yjeve, kalimi nga nata te dita, dhe, nga ana tjetër, ligjërimin poetik, që edhe ai prej Jacottet-së trajtohet si kalim fryme. Le t'i kthehemi dhe një herë, sepse e shpall mendimin e tij me qartësinë më të kristaltë: Fjalë-kalim, uverturë e lënë për frymën. Kështu i dashurojmë luginat, lumenjtë, shtigjet, ajrin. Na japin një dëshmi të frymës. Asgjë nuk ka përfunduar. Duhet ta bëjmë të ndjeshëm këtë avullim, si dhe besimin që bota nuk është tjetër veçse trajta kalimtare e frymës.

Kësisoj, visorja, kaq shumë e pranishme në prozën dhe në poezinë e Jacottet-së, merr një kuptim emblematik, që nuk mbaron te përshkrimi: kjo lartësi rrezatuese, kjo ndërtesë prej hapësire dhe ere, e populluar nga zogjtë, është, patjetër, një pamje e botës së dukshme; gjithsesi, ligjërimi, në kalim e sipër, mund të bëhet edhe: dritë, frymë, fluturim dhe klithmë e qartë. Poezia është njëherësh një shtjellim i ligjërimin të gjallë dhe një

shpalosje e hapësirës që i dhurohet vështrimit. Ky unitet plotësohet tek akti i kalimit, domethënë në mbretërinë e dukurive kalimtare, në botën e përbashkët ku ligji i vdekjes dhe i caktit nuk shmanget dot. I jemi taksur caktit: mësimi i rreptë i dënimit të kryelartëve nuk mund të harrohet. Sidoqoftë, jo pa ngulmin e gjallë të ndjesisë së një pakufishmërie që i jep kuptim caktit tonë – një pakufishmërie për të cilën nuk themi dot asgjë, por pa të cilën nuk do të merrte trajtë asnjëri prej caqeve tanë ligjërues. Pakufishmëria është, sipas Philippe Jaccottet-së, ndoshta emri i vetëm që mund t'i japim atij që më parë quhej Zot. Dhe, nëse poezia nuk e lakmon më zotërimin e saj, prapëseprapë ajo prej saj nuk heq dorë. Mbarë veprimtaria poetike i kushtohet pajtimit, a të paktën afrimit, të së kufishmes me të pakufishmen, të së ndritshmes me të errëtën, të frymës me trajtën [...] Ka të ngjarë që bukuria të lindet kur caku dhe pakufishmëria bëhen njëkohësisht të dukshme, domethënë kur shikojmë trajta duke hamendësuar në të njëjtën kohë se nuk thonë gjithçka, se nuk kufizohen te vetja, se i lënë së parrokshmes pjesën që i takon.

JEAN STAROBINSKI

GJONI

1946-1950

[NATA ËSHTË NJË QYTET I MADH NË GJUMË]

Nata është një qytet i madh në gjumë
ku era fryn... Erdhi nga larg gjer tek
azili i këtij shtrati. Është mesnatë qershori.
Ti fle, më sollën këtyre brigjeve pa anë,
era shkund lajthinë. Vjen kjo thirrje
që avitet dhe largohet, mu sikur
një dritë ikanake përmes pyllit, apo
hijet që shtjellohen, me sa thonë, në skëterrë.
(Kjo thirrje në natën verore, sa e sa gjëra
mund të thosha, dhe për sytë e tu...), por është veç
zogu i quajtur gjon, që na thërret thellë
këtij pylli në rrethina. Dhe tashmë vijmë erën
e kalbësirës në agim, tashmë nën lëkurë
kaq e ngrohtë eshtrat na i shpon,
teksa yjet terratisen nëpër qoshe rrugësh.

[JE KËTU, VËRTITET ZOGU I ERËS]

Je këtu, vërtitet zogu i erës,
ti ëmbëlsia, plaga, pasuria ime.
Kulla të mplakura drite mbyten
dhe dhembshuria zë e çel shtigje.

Toka është tani atdheu ynë.
Çapitemi midis barit dhe ujërave,
te ky va ku puthjet tona shkëndijojnë
kësaj hapësire ku do vetojë drapri.

Ku jemi? Të humbur në zemër
të paqes. Këtu, e vetmja gjë që flet,
nën lëkurën tonë, nën lëvore edhe tinë,

me furi prej demi, është gjaku
që duke marrë arratinë na trazon e na shkund
si ato kambanat e pjekura të fushave.